



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:191486
Datë: 19.03.2024
Numri i dokumentit: 05470527

Ac.nr.595/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Ardian Ajvazi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve I.M. dhe I.M. nga fshati, Komuna e Podujevës, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Xh.B., avokat në Prishtinë, kundër të paditurit I.V. nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.Sh., avokat në Prishtinë, për vërtetimin e pronësisë, duke vendosur sipas ankesës së paditësve të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1117/15, datë 09.09.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e paditësve I.M. dhe I.M. nga fshati, Komuna e Podujevës, PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1117/15, i datës 09.09.2019 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1117/15 të datës 09.09.2019, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësve I.M. dhe I.M. nga që të dy nga Podujeva, kundër të paditurit I.V. nga Prishtina, më të cilën kanë kërkuar që të “vërtetohet së paditësit janë bashkëpronar me nga ½ të ngastrës kadastrale numër....., në vendin e quajtur “...”, arë e klasit të ..., në sipërfaqe prej ha, si dhe të detyrohet i padituri që t’ua pranoj paditësve këtë të drejtë dhe t’ua lejoj regjistrimin në emër të tyre, si dhe shpenzimet e procedurës sipas vendimit të gjykatës”, si e pabazuar. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që

të: Detyrohen paditësit ,M. dhe I.M. nga fshati, Komuna e Podujevës, që të dy nga Podujeva, që të paditurit I.V. nga Prishtina, t'ia paguajnë shpenzimet e procedurës, në shumën prej 608.40 €, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditësve brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkëljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që: Gjykata e Apelit aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta ndryshoj dhe ta aprovoj kërkesëpadinë si të bazuar ose aktgjykimin e atakuar ta prish dhe shkresat e lëndës të ia kthej të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

Me përgjigje në ankesë i autorizuari i të paditurit ka kërkuar që Gjykata e Apelit ankesën e paditësve ta refuzoj në tërësi, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta vërtetoj.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësve është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit përmes të autorizuarit të tyre, me datë 08.08.2014, në gjykatën e shkallës së parë kanë paraqitur padi kundër të paditurit D.M. ish nga Prishtina për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, me propozim për caktimin e masës së sigurisë, me arsye dhe kërkesë si në padi dhe në propozimin për masë të sigurimit.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit për caktimin e masës së përkohshme, me aktvendimin C.nr.2224/14 dt.10.10.2014 e aprovoi propozimin dhe ka caktuar masën e sigurimit me të cilin i ndalohej kundërpropozuesit D.M. që të tjetërsoj, ngarkoj paluajtshmërinë..... , e cila evidencohet si p sh. KBI, në vendin e quajtur “....” ZK Prishtinë. Aktvendimi në fjalë është anuluar nga Gjykata e Apelit dhe çështja është kthyer në procedim të sërishëm.

Në seancën gjyqësore të datës 15.03.2016, i autorizuari i propozuesve të masës së sigurimit ka propozuar që tani e tutje si kundërpropozues i sigurimit të përfshihet I.V., pasi duke u bazuar në shkresat e lëndës shihet se pasuria ka kaluar në pronësi të I.V. nga Prishtina, gjersa në raport me kundërpropozuesin D.M. propozimin e ka tërhequr.

Gjykata e shkallës së parë në shqyrtimin e propozimit për masën e sigurimit, në riprocedurë me aktvendimin C.nr. 1117/15 të datës 16.11.2016, e refuzoi në tërësi propozimin si të pabazuar pasi vlerësoi se nuk plotësohen kushtet ligjore për caktimin e masës për sigurimin e kërkesëpadiës. Aktvendimi për refuzimin e propozimit siç rezulton nga shkresat lëndore, i është dorëzuar të autorizuarve të ndërgjyqësve, mirëpo kundër të njëjtit aktvendim nuk është parashtruar ankesë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1117/15, të datës 09.09.2019, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas administrimit të provave lidhur me ngastrën lëndore me numër 1679-0, ka vërtetuar gjendjen faktike se me kontratën mbi qiranë numër 113, datë 24.01.1968, paraardhësi i paditësve N.M. ka lidhur kontratë për dhënie me qira të ngastrës lëndore me numër 1679, në vendin e quajtur “....”, në

drejtim të qiramarrësit KBI - dhe atë në periudhë tri vjeçare. Ndërkaq me përfundimin e kontratës, pra nga viti 1971 në bazë të kontratës së vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë me numër OV.br.287/71, datë 16.02.1971, shihet së prona kontestuese ka kaluar në emër të KBI “.....” në Prishtinë. Pas bartjes në emër të KBI “.....” në Prishtinë, me aktvendimin e Komisionit për kthimin e tokave me numër 06-462-5/91, datë 29.03.1993, ngastra kadastrale kontestuese me numër në sipërfaqe prej m², Zona Kadastrale në Prishtinë, i është kthyer trashëgimtarit të paraardhësit M.D. ish nga Fushë Kosova, tani D.M. nga Fushë Kosova, tani me vendqëndrim në Beograd. Pas kthimit të pronës kontestuese në emër të D.M. i njëjti me datë 27.06.2014 ka bërë regjistrimin e pronës në emër të tij, ndërsa me kontratën e datës 31.07.2014, të lidhur në mes të D.M. nga Beogradi dhe I.M. nga Prishtina, ngastra lëndore e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë me numër 11-953-156150, me numër të njësisë kadastrale Zona Kadastrale në Prishtinë, lloji i njësisë: parcelë, vendi i quajtur “...”, në sipërfaqe prej m², i është bartë blerësit I.V. dhe atë për çmimin prej 250,000.00€ (dyqind e pesëdhjetë mijë euro), i cili çmim është përmbushur më rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate, e përfundimisht me datë 12.08.2014, e njëjta ngastër është regjistruar në emër të të paditurit I.V.

Gjykata ka shtuar se në rastin konkret kërkesëpadia e paditësve është në tërësi e pabazuar, për shkakun se paraardhësi i paditësve I.M. dhe I.M., asnjëherë nuk e ka pasur të evidentuar në emër të tij paluajtshmerinë kontestuese, ngase mungon dokumentacioni për periudhën para vitit 1971, për shkak se dokumentacioni lidhur me të njëjtën ngastër lëndore gjendet në shtetin e Serbisë, e që e njëjta paluajtshmeri që nga viti 1971 me përfundimin e kontratës për qiranë ishte evidentuar në emër të KBI “.....” në Fushë Kosovë, e me pas në vitin 1993, paluajtshmeria lëndore i është kthyer paraardhësit juridik të të paditurit D.M., ndërkaq përfundimisht në vitin 2014 ka kaluar në emër të të paditurit I.V., sipas kontratës së lartcekur dhe me regjistrimin në Regjistrin për Regjistrimin e Paluajtshmerive. Me nenin 52 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, përcaktohet se “Kontrata në bazë të së cilës transferohet titulli i paluajtshmerisë ose përmes së cilës krijohet një e drejtë tjetër subjektive për paluajtshmerinë duhet të lidhet në formën e shkruar”. Me nenin 36 paragrafi 1 të Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, është paraparë se “Për bartjen e pronësisë në paluajtshmeri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmeri”, tutje në paragrafin 2 të po të njëjtit nen, parashihet se “Kontrata për bartjen e paluajtshmerisë duhet të lidhet me shkrim në prezencë të dy palëve në një zyrë kompetente”. Ndërkaq me nenin 287 paragrafi 1 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, është paraparë së “Për fitimin e pronësisë në një paluajtshmeri është i nevojshëm regjistrimi në Regjistrin për të drejtat në paluajtshmeritë, nëse Regjistri është themeluar dhe ka filluar veprimtaria e regjistrimit”, andaj në rastin konkret meqenëse paditësit nuk kanë ofruar asnjë provë me të cilat do të mund të vërtetonin të drejtën e pronësisë mbi pronën kontestuese, gjykata erdhi në përfundim të kërkesëpadia e paditësve është në tërësi e pabazuar, pasi që i padituri i ka ndjekur të gjitha kërkesat ligjore të lartcekura. Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet tjera të palës paditëse, mirëpo të njëjtat ishin pa ndikim në vendosjen ndryshe, përpos si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Lidhur me mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 36 paragraf 1 dhe 2 dhe 287 paragraf 1 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, lidhur me nenin 52 të LMD-së. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata e ka mbështetur në nenin 450 dhe 452 paragraf 2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes, nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1 lidhur me nenin 160 pika 4 dhe 5 të LPK-së. Gjendja

faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë, me çka ka ardhur edhe gjer tek zbatimi apo aplikimi i gabuar i së drejtës materiale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1 lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi ka të meta të atilla për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet. I njëjti aktgjykim nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta dhe pa mbështetje në provat nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale-juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale-juridike, jep përfundimin mbi pathemelësinë e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit me referim në shkresat e lëndës konsideron se ka paqartësi se kush është palë e paditur në këtë çështje kontestimore. Kështu, me referim në procesverbalin e seancës dëgjimore C.nr.2224/14, dt. 15.03.2016, rezulton se i autorizuari i paditësve/propozuesve ka bërë zgjerimin e padisë në pikëpamje subjektive, ashtu që të përfshihet I.S.V. gjersa e njoftoi gjykatën se e tërheq propozimin për caktimin e masës së sigurimit ndaj kundërpropozuesit D.M. Në prezencë të këtyre rrethanave, përkatësisht nga zgjerimi i padisë si në seancën në fjalë, rezulton se i paditur në këtë çështje kontestimore duhet të ishte edhe D.M. bashkë me të paditurin I.S.V, pasi tërheqja e propozimit për masën e sigurimit në raport me kundërpropozuesin, sipas gjykatës ankimore tani për tani nuk çon në përfundimin se paditësit kanë tërhequr padinë në raport me të paditurin e parë, ndaj të cilit ishte iniciuar fillimisht procedura kontestimore dhe që ky i paditur kishte ndërmarrë edhe veprime për tjetërsimin e pronës së paluajtshme lëndore në të cilën paditësit pretendojnë të drejtën në pronë.

Gjithashtu gjykata e shkallës së dytë vlerëson se aktgjykimi i atakuar është marr edhe me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 paragraf 1 të LPK-së, lidhur me nenin 99, për arsye se padia e datës 08.08.2014 nuk përmban elementet që duhet t'i përmbajë çdo parashtesë. Në këtë rast gjykata para se të vendosë në mënyrë meritore për kërkesëpadinë e paditësve, është dashur që padinë e paditësve ta kthejë në rregullim - korigjim, në kuptim të nenit 99 dhe 102 e lidhur me nenin 2 paragraf 1 të LPK-së dhe pastaj të administroj provat për vërtetimin e themelësisë së kërkesëpadisë.

Për shkak të paqartësisë në përmbajtjen formale të padisë, sa i përket palëve në procedurë dhe objektit të kërkesëpadisë, kolegji i kësaj gjykata vjen në përfundim se nga provat e administruara gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur që të vërteton në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve sipas pretendimeve nga padia, sa i përket bazës juridike të kërkesëpadisë për vërtetimin e të drejtës në pronë dhe eventualisht vlerësimit të ligjshmërisë së kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë me numër LRP.nr.12868/14 datë 31.07.2014, gjegjësisht provave që janë me ndikim për vlerësimin e themelësisë së kërkesëpadisë. Si shkak i vërtetimit jo të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka ardhur edhe deri të zbatimi i gabuar i së drejtës materiale, për të cilën gjykata ankimore kujdeset sipas detyrës zyrtare, me çka mbi bazën e shkeljeve të konstatuara aktgjykimi i atakuar u dashtë që të prishet dhe të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që t'i evitojë shkeljet e theksuara në atë mënyrë që fillimisht të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës ndërsa padinë e paraqitur

nga ana e paditësve ta kthejë në plotësim dhe korrigjim në kuptim të nenit 99 dhe 102 të LPK-së. Pas plotësimit të kushteve formale, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike të caktoj seancën e shqyrtimit kryesor dhe të zhvilloj procedurën për administrimin e provave të propozuara nga ndërgjyqësit. E rëndësishme në këtë çështje kontestimore është nxjerrja e provave për të konstatuar historikun e kalimit të pronës së paluajtshme— objekt kontesti nga njëri titullar në tjetrin, pra kur është bërë regjistrimi i pronës në emër të KBI dhe mbi çfarë baze; deri kur paditësit kanë ushtruar pushtetin juridik dhe faktik në atë paluajtshmëri, a kanë paraqitur ndonjë vërejtje me shkrim përkitazi me ndërrimin e pronarit dhe a kanë kërkuar në procedurë tjetër gjyqësore në gjykatën me kompetencë lëndore, njohjen e të drejtës në pronë. Përfundimisht, pas vlerësimit të provave, me aplikimin e drejtë të ligjit material, gjykata të vendos në mënyrë meritore për aprovimin apo refuzimin e kërkesëpadisë, duke u kujdesur që aktgjykimi në përmbajtje dhe strukturë të hartohet në kuptim të dispozitave ligjore nga neni 160 të LPK-së.

Gjykata shkallës së parë në rigjykim sipas kërkesës së palëve në procedurë të vendosë në mënyrë të drejtë edhe lidhur me shpenzimet e shkaktuara palëve në procedurë, duke pasur parasysh suksesin e tyre në procedurë dhe shpenzimet të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes së tyre në gjykatë.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 paragraf 1 pika c) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.595/20, me datë 21.02.2024

Kryetare e kolegjit
Hunaida Pasuli